

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2007

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur rëndësinë kushtetuese të institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

- duke vlerësuar rolin e këtij institucioni të paanshëm për rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës shtetërore në nivel qendror e vendor, sistemit gjyqësor dhe prokurorisë, nëpërmjet rekomandimeve të dhëna dhe masave të propozuara;

- duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e këtij institucioni për krijimin e standardeve bashkëkohore në fushën e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut dhe kontributit të dhënë për përmirësimin e legjislacionit vendas, sipas standardeve ndërkombëtare,

Vëren se për vitin 2007:

- veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2007 ka synuar mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë, në përputhje me Kushtetutën, konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar;

- institucioni i Avokatit të Popullit ka punuar për përmbushjen e objektivave, sipas rezolutës së miratuar nga Kuvendi;

- ka zhvilluar një volum pune të konsiderueshëm, duke i dhënë drejtimin e duhur edhe ankesave që janë jashtë juridiksionit të tij;

- marrëdhëniet me Kuvendin, Këshillin e Ministrave, institucionet e tjera qendrore dhe ato të pavarura kanë ardhur duke u përmirësuar në mënyrë të ndjeshme;

- marrëdhëniet me shtetasit shqiptarë, duke shkuar si institucion pranë tyre në bashki, komuna apo qarqe, kanë dhënë rezultate të dukshme në punën e tij.

Kuvendi kërkon për vitin 2008:

- angazhimin më të plotë të institucionit të Avokatit të Popullit për kryerjen e një pune informuese dhe sqaruese për kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, si dhe për mbrojtjen e respektimin e të drejtave të njeriut;

- vendosjen e një marrëdhënieje bashkëpunimi të vijueshëm me Televizionin Publik Shqiptar, për të vendosur një komunikim të drejtpërdrejtë me të gjithë shtetasit shqiptarë;

- rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të publikut për kërkimin e të drejtave të shkelura apo të mohuara;

- vendosjen e mbajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit e të mirëkuptimit si me organizmat ndërkombëtarë, ashtu edhe me forcat politike, shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse dhe median;

- ndjekjen deri në përmbushje të rekomandimeve të bëra dhe masave të propozuara të këtij institucioni drejtuar institucioneve shtetërore dhe administratës publike;

- denoncimin në vijimësi të shkeljeve të të drejtave të shtetasve nga administrata shtetërore, qendrore apo vendore.

14 prill 2008